



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:247835

Datë: 22.12.2021

Numri i dokumentit: 02544637

C.nr.1018/21

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-DEGA NË MALISHEVË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Nehat Qelaj dhe sekretarin juridik Xhavit Morina në çështjen juridike të paditësit, Kompania për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a. (K.) me seli në Prishtinë Rr “Bulevardi Bill Klinton nr.3 Ndërtesa e Elektrokosovës Kati II numër 5,P. ..., Republika e Kosovës, kundër të paditurit Z. (S.) I. nga fshati L., Komuna e Malishevës, për shkak të kompensimit të dëmit material, vlera: **251.94 Euro**, me datën **22.12.2021**, mori këtë:

A K T G J Y K I M
për shkak të pa dëgjueshmërisë/ mosbindjes

MIRATOHET kërkesë-padia e paditësit, Kompania për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a. (K.) me seli në P. Rr “Bulevardi Bill Klinton nr.3 Ndërtesa e Elektrokosovës Kati II numër 5,P. ... në tërësi **si e bazuar**.

DETYROHET i padituri Z. (S.) I. nga fshati L., Komuna e Malishevës t’ia kompensoj shumën prej 251.94 €, (dyqind e pesëdhjetë e një euro e nëntëdhjetë e katër cent) për dëmin e shkaktuar material Kompanisë për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a. (K.) me seli në P. Rr “Bulevardi Bill Klinton nr.3 Ndërtesa e Elektrokosovës Kati II numër 5, P. ..., me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga nxjerrja e Aktgjykimit datës **22.12.2021**, e deri në përmbushjen definitive të detyrimit si dhe shpenzimet procedurale në shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 7 (ditësh) pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcenim të përbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësi Kompania për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a. (K.) me seli në P. Rr “Bulevardi Bill Klinton nr.3 Ndërtesa e Elektrokosovës Kati II numër 5, P. ..., me datë 21.10.2021, ka parashtruar në këtë Gjykatë padinë kundër të paditurit Z. (S.) I. nga fshati L., Komuna e M., për shkak të kompensimit të dëmit material në vlerë prej 251.94 €, duke theksuar ndër tjerash se i padituri deri me datat 02.08.2018, 05.09.2018, 13.10.2018,05.11.2018 dhe deri me datën 20.03.2019, me qëllim që ti sjell vetit pasuri të kundërligjshme ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar, ashtu që jashtë njehsorit elektrik përmes kablos është lidhur direkt në rrjetin elektrik, me këto veprime energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar.

Sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Gjakovës, dega në Malishevë, me numër P.nr.94/20, të datës 02.06.2021, i cili ka marrë formën e prerë me datën 02.07.2021, i padituri është shpallur fajtor për shkak të kryerjes së veprës penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314/6-1 të Kodit Penal

të Republikës së Kosovës, përderisa e dëmtuara, tani Paditësja për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga kryerja e veprës penale të lartpërmendur, është udhëzuar në kontest civil. Me veprimin e tij i Padituri, i ka shkaktuar Paditëses dëmin material në vlerë prej 251.94 euro.

Gjykata në kuptim të nenit 394, 395 al.1 dhe 2 të Ligjit të procedurës kontestimore i ka dërguar të paditurit padinë, provat materiale dhe aktvendimin për dhënien e përgjigjes në padi.

Duke e bërë shikimin në fletë dërgesë për dorëzimin personal konstatohet se me datë 27.11.2021, paditësi personalisht i ka marr aktvendimin për përgjigje në padi i datës 23.11.2021, së bashku me padinë dhe provat materiale, mirëpo edhe pse ka kaluar afati i paraparë për dhënien e përgjigjes në padi, i njëjti nuk e ka parashtruar përgjigjën në padi, andaj duke u bazuar në dispozita ligjore të nenit 150 al.1 pika (a),(b) dhe (c), të LPK-së të lartë cituar, Gjykata mori Aktgjykim për shkak të pa dëgjueshmërisë (mosbindjes) ndonëse janë plotësuar kushtet si më poshtë vijojnë:

- a) Të paditurit i është dorëzuar në mënyrë të rregull padia, provat materiale dhe thirrja-Aktvendimi për dhënien e përgjigjes në padi,
- b) Themelësia e kërkesë padisë rezulton nga faktet e treguar në padi, dhe
- c) Faktet mbi të cilat mbështet kërkesë-padia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë konform nenit 452 paragraf.1 të LPK-së me ç ‘rast palës paditëse i janë pranuar shpenzimet 20 euro në emër të taksës gjyqësore për padi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-DEGA NË MALISHEVË
Departamenti i përgjithshëm Divizioni Civil
C.nr.1018/21, e datës 22.12.2021

GJYQTARI
Nehat Qelaj

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimit është e lejuar ankesa, Gjykatës së Apelit në afat brenda 7 dite nga dita e pranimin të së njëjtit, ankesa dorëzohet nëpërmjet të kësaj gjykate.